



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1926/ 7 prot

Datë 04.11.2021

V E N D I M  
Nr. 854/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2021 me

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Biometric Albania*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-97559-06-07-2021, me objekt “*Furnizim Vendosje Aparatura Mjekësore, Mobilimi dhe Hotelerie për Godinën e Re të Pediatrisë, Ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore*”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër (në total për të gjitha lotet): 108,245,244.67 (njëqind e tetë milion e dyqind e dyzet e pesë mijë e dyqind dyzet e katër pikë gjashtëdhjetë e shtatë tridhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër presje pesë) Lekë pa TVSH, **Loti 2** me Nr. REF-97566-06-07-2021 me objekt “*Pajisje anestetike dhe të Frymëmarrjes*” me fond limit/vlerë të pritshme të kontratës 9,368,517.60 (nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.

**Autoriteti Kontraktor:**

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”  
Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK

Adresa: Rruga “Vllazën Huta”, Pall. Vila Park 1/6/25,  
Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.06.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-97559-06-07-2021, me objekt “Furnizim

Vendosje Aparatura Mjekësore, Mobilimi dhe Hotelerie për Godinën e Re të Pediatriisë, Ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër (në total për të gjitha lotet): 108,245,244.67 (njëqind e tetë milion e dyqind e dyzet e pesë mijë e dyqind dyzet e katër pikë gjashtëdhjetë e shtatë tridhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër presje pesë) Lekë pa TVSH, **Loti 2** me Nr. REF-97566-06-07-2021 me objekt “Pajisje anestetike dhe të Frymëmarrjes” me fond limit/vlerë të pritshme të kontratës 9,368,517.60 (nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.

II.2. Në datën 16.08.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 23.09.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Montal” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
2. “Biometric Albania” SHPK	5,870,000 lekë	skualifikuar
3. “Fedos” ShPK	7,500,000 lekë	skualifikuar
4. “O.E.S Distrimed” SHPK	8,017,100 lekë	skualifikuar

II.4. Më datë 23.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyet si më poshtë vijon:

Bazuar në Ligjin Nr162/2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 93 dhe neni 66 pika 5 e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar sipas të cilit: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP (Neni 93, Ligji 162/2020), oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur, KVO ka përlllogaritur se Oferta e OE “Biometric Albania” shpk, rezulton të jetë anomalisht e ulët. Për këtë arsye KVO ju drejtua në SPE për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët si më poshtë: Në vijim të vlerësimit të bërë për procedurën e prokurimit: “F.V Aparatura Mjekësore, Mobilimi dhe Hotelerie për Godinën e Re të Pediatriisë, Ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore”; i ndare ne lote (22 lote gjithsej), “Procedurë e Hapur” dhe bazuar ne VKM 914 datë 29.12.2014 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, Neni 66 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 5:

5) Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP (Neni 93, Ligji 162/2020), oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë

oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP(Neni 93,Ligji 162/2020), oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlerësimeve. Gjatë shqyrtimit të ofertës tuaj ekonomike, rezulton se oferta me vlerë totale: 5,870,000 është ofertë anomalisht e ulët. Sa më sipër, lutemi të paraqisni me shkrim, sqarimet dhe argumentimet për ofertën anomalisht të ulët. Afati për të dhënë sqarime/shpjegime do të jetë deri në dt. 15.09.2020 ora 15:00. KVO administroi dokumentacion (bashkëlidhur) dhe vlerësoi se nuk plotëson kushtet dhe forma ligjore për tu konsideruar si ofertë e vlerësimeve për arsyet si më poshtë:

Nga vlerësimi i argumentimit të ofertës në ALL referuar kursit të këmbimit të referuar po nga Biometric, rezulton se:

\* Vlera totale e ofertës në ALL, sipas shkresës së Biometric me dt.15.09.2021 nuk ka % të normës së fitimit rreth 16% por rreth 17 (17.4125321%)

\* Vlera totale e ofertës në ALL, sipas tabelave të cmimeve bashkangjitur shkresës së Biometric më dt.15.09.2021 nuk ka % të normës së fitimit rreth 16% por rreth 17 (17.4223411%) % e normës së fitimit në 2 dokumentat që argumentojnë ofertën, janë të ndryshme midis tyre dhe të ndryshme me referimin në shkresën e OE.

Artikulli 1 dhe 2:

Cmimi për aksesorët e artikujve 1 dhe 2 të Jike janë përfshirë në ofertën e Mindray JIKE nuk ka dorëzuar një ofertë sqaruese me firmë dhe me vulë të kompanisë JIKE

Artikulli 3

ALSA nuk ka dorëzuar një ofertë sqaruese me firmë dhe me vulë të kompanisë ALSA (tabela e cmimeve ka vetëm logon e ALSA)

Cmimi i blerjes të deklaruar nga Biometric është 463€, cmimi sipas listës bashkangjitur është 456.5€

Artikulli 4 dhe 5:

GIMA nuk ka dorëzuar një ofertë sqaruese me firmë dhe me vulë të kompanisë GIMA (tabela e cmimeve nuk ka asnjë element të GIMA)

Cmimi i blerjes të deklaruar nga Biometric është 157€, cmimi sipas listës bashkangjitur është 160.10€

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave më datë 23.09.2021, si dhe më datë 07.10.2021 ka anuluar në sistem procedurën e prokurimit.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 12.10.2021 operatori ekonomik ankimes "Biometric Albania" SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Biometric Albania" SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.1926/2 prot., datë 13.10.2021 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “*Biometric Albania*” SHPK.

II.8. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 1926/3 prot datë 25.10.2021, i ka kërkuar autoritetit kontraktor, të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepën argumentat përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “*Biometric Albania*” SHPK

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 2609/8 prot., datë 26.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1926/5 prot., datë 29.10.2021 me objekt “*Kthim-përgjigje mbi Formularin e Ankesës të administruar pranë Autoritetit Kontraktor me Nr. 2609 prot., datë 12.10.2021 nga OE “Biometric Albania” SHPK*, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*Biometric Albania*” SHPK dhe me shkresën nr. 2609/8 prot., datë 26.10.2021, e ka njoftuar atë dhe operatorët e tjerë ekonomik të interesuar se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

“[...] KSHA arriti në, Konkluzionin:

-Të pranojë pretendimet e paraqitura nga OE “*Biometric Albania*” SHPK, në ankesën e administruar me nr. 2609 prot., datë 12.10.2021.

-KVO të rivlerësojë dokumentacionin e paraqitur për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, duke kualifikuar ofertën e OE ankues si ofertë të vlefshme[...].”

II.11. Me shkresën nr. 1926/5 prot., datë 02.11.2021 Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza me kërkesën për informacion për sa më poshtë:

1. A kanë paraqitur argumente pranë autoritetit tuaj kontraktor në cilësinë e operatorëve ekonomikë të interesuar, operatorët e tjerë pjesëmarrës “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Fedos” SHPK ?

II.12. Me shkresën nr. 2609/14 prot., datë 03.11.2021 protokolluar me tonën nr. 1926/6 prot., 04.11.2021 Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza njofton Komisionin e Prokurimit Publik se:

*“ Për sa më sipër asnjë nga operatorët ekonomik të interesuar “O.ES Distrimed” SHPK dhe “Fedos” SHPK, nuk kanë paraqitur argumente në lidhje me vendimin e marrë nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit me objekt: Furnizim Vendosje Aparatura Mjekësore, Mobilimi dhe Hotelerie për Godinën e Re të Pediatriisë, Ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore”; i ndarë në lotë (22 lote gjithsej), Loti 2 – Pajisje anestetike dhe të frymëmarrjes, me Ref-97566-06-07-2021..”*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues *“Biometric Albania”* SHPK dhe me shkresën nr. 2609/8 prot., datë 26.10.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

Për këtë arsye, fillimisht vlerësoi dokumentacionin e paraqitur dhe përlllogaritit nëpërmjet ekonomistes pjesë e KSHA vlerat e paraqitura në dokumentacionin e administruar nga OE ankimues. Referuar dokumentacionit që argumenton orertën anomalisht e ulet për këtë LOT, OE ankues nëpërmjet dokumentacionit të vënë në dispozicion

*“[...] KSHA arriti në, Konkluzionin:*

*-Të pranojë pretendimet e paraqitura nga OE “Biometric Albania” SHPK, në ankesën e administruar me nr. 2609 prot., datë 12.10.2021.*

*-KVO të rivlerësojë dokumentacionin e paraqitur për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, duke kualifikuar ofertën e OE ankues si ofertë të vlefshme[...].”*

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 *“Për prokurimin Publik”* i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe*

vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, pika 1 dhe 2 e nenit 115 dhe neni 118 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-97559-06-07-2021, me objekt “Furnizim Vendosje Aparatura Mjekësore, Mobilimi dhe Hotellerie për Godinën e Re të Pediatriisë, Ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër (në total për të gjitha lotet): 108,245,244.67 (njëqind e tetë milion e dyqind e dyzet e pesë mijë e dyqind dyzet e katër pikë gjashtëdhjetë e shtatë tridhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër presje pesë) Lekë pa TVSH, **Loti 2** me Nr. REF-97566-06-07-2021 me objekt “Pajisje anestetike dhe të Frymëmarrjes”

me fond limit/vlerë të pritshme të kontratës 9,368,517.60 (nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
  3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Biometric Albania*” SHPK.
  4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**